# DËSHMI ARKIVI

**A-449297**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rivera sulmon rikthimin e Mancinit në Kombëtare: Fyerje për tifozët dhe lojtarët |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/rivera-sulmon-rikthimin-e-mancinit-ne-kombetare-fyerje-per-tifozet-dhe-lojtaret/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 13:16:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 13:14:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 13:13:00 UTC → 16 shtator 2026, 13:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 7b323dc6aaf6af5b3054ddc0e7a00df8b46cf0e26e77900d6cc35537c14954cb |
| TEKSTI | 4b88ddf2202b6ec0c7780d3ca60584e2fc23635c4b889b8f546a39eaa81f3325 |
| PAMJA | 4325a07daf06fe2cbb7faa7d78a434f725a9f8d8633dac21a01d656ea865761b |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 998ed2c5b23185ed4e12749151557d9fb1284d69fee155167b2661b7bc363c71 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/998ed2c5b23185ed4e12749151557d9fb1284d69fee155167b2661b7bc363c71`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rivera sulmon rikthimin e Mancinit në Kombëtare: Fyerje për tifozët dhe lojtarët

16/09/2026 15:14



**Gianni Rivera ka dalë hapur kundër rikthimit të Roberto Mancinit në stolin e Kombëtares së Italisë, duke e cilësuar vendimin e drejtimit të ri të Federatës Italiane të Futbollit si të papranueshëm.**

Në një intervistë për "Il Fatto Quotidiano", legjenda e futbollit italian dhe fituesi i Topit të Artë në vitin 1969 nuk i ka kursyer kritikat ndaj zgjedhjes së Federatës. "Të rikthesh Mancinin në stol është një fyerje për tifozët dhe lojtarët", është shprehur Rivera.

Ish-ylli i Milanit thotë se do ta kishte parë ndryshe një rol për Paolo Maldinin në këtë projekt, ndërsa rikthimin e Mancinit e kundërshton hapur. Rivera e lidh këtë qëndrim edhe me largimin e mëparshëm të trajnerit nga Kombëtarja dhe zhvillimet që pasuan. Por kritikat e Riverës nuk ndalen te pankina e Italisë. Ish-kampioni e ka zgjeruar diskutimin te mënyra se si funksionon sot futbolli botëror, duke vënë në qendër të vëmendjes peshën e parave.

"Bota e futbollit, nga Blatter te Infantino, gjithmonë e ka pasur paranë si zot. Për sa kohë që komandon paraja, futbolli nuk do të ndryshojë", ka deklaruar Rivera. Sipas tij, edhe marrëdhënia mes futbollistëve dhe klubeve ka ndryshuar ndjeshëm. "Lojtarët sot janë kompani dhe bëjnë skuadër me të tjerët vetëm në fushë", është shprehur ish-numri 10 i Italisë.

Rivera ka folur gjithashtu për raportin e tij me institucionet e futbollit. Ai ka deklaruar se gjatë viteve ka refuzuar oferta të shumta për të bërë reklamë dhe se nuk është tërhequr nga ideja për t'u përfshirë në nivelet e larta të futbollit për arsye ekonomike. "Nuk kam bërë kurrë reklamë për askënd, pavarësisht se propozimet që kam marrë ndër vite kanë qenë të shumta dhe fitimprurëse", ka treguar ai.

Dhe në fund, Rivera ka shpjeguar edhe mënyrën se si e sheh veten në raport me sistemin: "Jam i parehatshëm, dje si sot, sepse idetë e mia gjithmonë shqetësojnë pushtetin." Deklarata që rikthejnë në qendër të vëmendjes një nga zërat më kritikë të futbollit italian, pikërisht në një moment kur Kombëtarja dhe drejtimi i ri i FIGC po përballen me një kapitull të ri.

**Top Channel**

## Futboll »





## SPORT • KRYESORE



"UÇK nuk është vetëm një emër në histori"/ Sulmuesi i Kombëtares shqiptare reagon pas vendimit të marrë në Hagë



Europa League ngre siparin, Milan–Benfica dhe sfida e Arbër Hoxhës, LIVE në Digitalb



Trishtim në familjen Koeman, ish-trajneri i Barcelonës humbet njeriun e dashur



Europa League në sezonin e ri, sa përfiton skuadra fituese? Publikohen shifrat



Nuk mund të luajë më me Shqipërinë, sulmuesi i talentuar grumbullohet nga Jurgen Klopp

## ME TË LEXUARAT

Nuk mund të luajë më me Shqipërinë, sulmuesi i talentuar grumbullohet nga Jurgen Klopp

Carlos Espí heroi i Madridit, Reali merr fitoren në frymën e fundit

Nuk i besohet në kampionat, Mario Mitaj merr më në fund minuta me



Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »

Top Channel/ Lot dhe protestë në Prishtinë. Turma marshoi drejt EULEX-it, policia bllokoi hyrjen

Top Channel/ Kurti: Padrejtësi e papranueshme. Aktgjykimi duhet korrigjuar në Apel

Top News- 'Garantoni sigurinë', BE bën thirrje për vetëpërmbajtje pas protestës te EULEX

Top Channel/ Tensione pas vendimit në Hagë. Protestues me simbole UÇK hipën mbi makinat e policisë

Top News – Agresori ishte Serbia, viktima Kosova. PDK reagon ndaj dënimit të Hagës – Padrejtësi!

Top Channel/ Totali 81 vite burg: Gjykata "shfajësoi" UÇK-në: "Faji ishte individual"!



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.